




**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**



Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: “ **Albo Group “sh.p.k. & “ EV “**, me seli në Prishtinë, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën 01.07.2020, merr këtë:

## **V E N D I M**

- 1. Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Kandidatin e suksesshëm të subjektit në procedurë: “ **Albo Group “sh.p.k. & “ EV “**,, me seli në Prishtinë, në procedurën e prokurimit me titull: “ **Hartimi i Planit të Implementimit dhe Menaxhimit të Zonës Ekonomike në Vushtrri “** Nr.i prokurimit: **VU644 – 20 – 2262 – 3-3-2** e Nr. i brendshëm: **644-20-024-332**.
- 2. Vërtetohet si i bazuar** Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 25.06.2020

## **A r s y e t i m**

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ( në tekstin e mëtejme A.K. ) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të Kandidatëve në Procedurë e Kufizuar, ka marrë vendim që në **Fazën e Parë të Para Kualifikimit** t’i kualifikoi tre Kandidatë në mesin e të cilëve është edhe parashtruesi i Kërkesës për Rishqyrtim : Grupi i Op. Ek.: “ **Albo Group “sh.p.k. & “ EV “**,, me seli në Prishtinë, bazuar në procedurën e zbatuar.

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për Kandidatët e kualifikuar dhe atyre të pa kualifikuar u janë dërguar, në rrugë elektronike, të gjithë pjesëmarrësve në aktivitetin e prokurimit në fjalë, më dt. 25.06.2020, bazuar në dispozitat e nenit 43 të Rregullores mbi Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se A.K. duke vendosur si në Vendimin e dt. 25.06.2020 ka shkelur dispozitat e LPP-së , konkretisht: nenin 1-Qëllimi, nenin, neni 7–Barazia dhe Trajtimi, nenin 28 – Specifikat Teknike, nenin 69 – Aftësia Teknike dhe / ose Profesionale, nenin 4, 26.2 , 26.5, 39.8 dhe 41.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, më tej ( ROUPP ).

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë, për arsye se:

1. Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Neni 33 paragrafi 1 ( **Procedurë e Kufizuar** ), duke i kushtuar kujdes dhe promovimit të transparencës. Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se Vendimi i A.K. i dt. 25.06.2020 është marrë bazuar në kushtet , rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së, vendimi, sikurse ka vlerësuar A.K., është i mbështetur mbi baza ligjore e faktike, i pandikuar nga interesat

personale, që nuk diskriminon dhe që ka një transparencë të lartë të vendimmarrjes dhe po ashtu duke zbatuar kërkesat procedurale dhe qenësore të dispozitave të LPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e kandidatëve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese. Vendimi për ti parakualifikuar tre kandidatë është marrë në mes tjerash edhe në zbatimin e nenit 59 të LPP-së, sepse një tender do të konsiderohet i përgjegjshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse përmbushë minimalisht kërkesat e përzgjedhjes të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, andaj pretendimi i Ankuesit se A.K., me qëllim që ta plotësoi kriterin që minimum tre O.E. të jenë të përgjegjshëm, ka parakualifikuar dhe Ankuesin është jo vetëm paragjykes por edhe i pasaktë dhe për rrjedhojë dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së.
3. Kërkesat minimale të kualifikimit, të cilat së bashku dhe me Kriteret e përshtatshmërisë karakterizohen edhe si Kriteria të Përzgjedhjes - Parakualifikimit, të saktësuar si në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, sikurse ka vlerësuar A.K., janë proporcionale dhe në harmoni me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve të cilat janë lëndë e aktivitetit të prokurimit në fjalë, e që është në pajtim dhe me nenin 51 të LPP-së sa i përket Krieteve të përzgjedhjes për parakualifikim. Pretendimi i Ankuesit se ai, si i parakualifikuar, nuk i përmbush kërkesat teknike për parakualifikim dhe për këtë arsye është dashur që të eliminohet, është jo vetëm i pasaktë por në të njëjtën kohë parqet në një rast të papresedent në praktikën e prokurimit. Nëse kemi parasysh dhe faktin se A.K., pikërisht mbi bazën e Kërkesës për Sqarim Tenderi të parashtruar nga parashtruesi i Kërkesë për Rishqyrtim ka bërë dhe zgjerimin e fushëveprimtarisë së shërbimeve në Kërkesat Teknike dhe / ose profesionale, pikërisht për t'iu mundësuar O.E. – Kandidatëve pjesëmarrje sa më të madhe në këtë aktivitet. Githashtu A.K. vlerëson se Ankuesi padiskutueshëm i përmbushë kërkesat lidhur me aftësitë teknike dhe / ose profesionale nga se projektet – shërbimet e përfunduara në tre vitet e fundit dhe të saktësuar në Listën e projekteve të përfunduara e të pasqyruara dhe me referenca adekuate tregojnë arsyeshëm dhe padiskutueshëm se Ankuesi, gjatë tre viteve të fundit, ka të përfunduara suksesshëm disa projekte që përmbushin kërkesat e A.K. si në pikëpamje të natyrës së shërbimeve të përfunduara ashtu edhe në pikëpamje të vlerës së kontratave të ekzekutuara. Në këtë drejtim AK. ka evidentuar disa kontrata të përfunduara dhe që janë të natyrës së ngjashme me natyrën e aktivitetit të prokurimit, sikurse janë projektet e “ Ekovizioni “ OJQ :

- “ Menaxhimi i mbeturinave medicinale “ në vlerë prej 29.904,92€
- “ Mendo xhelbër “ në vlerë prej 7.000,00€, ndërsa

Projekte të natyrës së ngjashme me natyrën e aktivitetit të prokurimit të përfunduara në tre vitet e fundit nga O.E.” Albo Group “sh.p.k. janë marrë parasyshë:

- “ Hartimi i strategjisë zhvillimore lokale të turizmit 2020 – 2024 në Komunën e Skenderajit “ në vlerë prej 6.985,60€, e që janë vlerësuar si kontrata respektivisht shërbime që ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal, regjional ose rural, ose konsulencë në hartimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal.

4. Po ashtu është me interes të sqarohet se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve respektivisht vlerësimi i dëshmive të dorëzuara në dosjen e tenderit dhe marrja e Vendimit mbi bazën e vlerësimit të dëshmive të dorëzuar është marrë në pajtim të plotë me nenin 41 pika 41.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik sa i përket kërkesave lidhur me përgjegjshmërinë e O.E. – Kandidatëve pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit në fjalë.
5. Lidhur me pretendimet tjera të Ankuesit se, me rastin e marrjes së vendimit, A.K. ka shkelur nenin 4 – trajtimi i barabartë i O.E., nenin 26.2 – Kriteret e Përshtatshmërisë ose nenin 26.5 - Kriteret e Përzgjedhjes dhe nenin 39.8 – Kërkesë për sqarim tenderi, A.K. ka vlerësuar se me asnjë dëshmi nuk mundë të vërtetohet se pretendimet ankimore të Ankuesit janë të bazuara, sepse, me asnjë provë Ankuesi nuk ka dëshmuar se A.K. ka trajtuar jo barabartë O.E., apo se ka vlerësuar gabimisht dhe / ose jo drejtë dëshmitë e dorëzuara lidhur me aftësitë teknike dhe / ose profesionale të O.E.. Ndërsa sa i përket nenit 39.8 të RUOPP lidhur me sqarim tenderi, A.K. bazuar në të drejtën dhe nevojën e tij ka vlerësuar se është plotësisht e panevojshme të kërkohet ndonjë sqarim tenderi nga ndonjë O.E. – Kandidat.



6. Në fund A.K. vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit për ti parakualifikuar tre kandidatët si në Vendimin e dt. 25.06.2020 nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, konkretisht neni 1-Qëllimi, neni 7–Barazia dhe Trajtimi sepse me asnjë provë nuk është vërtetuar se ndonjë O.E. është trajtuar Jo-barabar apo në mënyrë diskriminuese, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes O.E., neni 59 parag.4 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, neni 69 – Aftësia Teknike dhe Profesionale, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K., janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
K.R. nr. 028/2020 - datë 01/07/2020

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)

Drejtoria për Prokurim Publik



---

Hyda Dallku-ZPP